



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT
SHTETËROR TË CILËSISË DHE I AGJENCISË SË
KOSOVËS PËR AKREDITIM PËR VITIN 2024**

Prishtinë, mars, 2025

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
1. HYRJE.....	5
2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA).....	5
2.1. Misioni dhe qëllimet e AKA-së.....	7
2.2. Anëtarësimet dhe partneritetet.....	7
2.3. Reformat kryesore – miratimi i akteve nënligjore.....	8
2.3.1. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-2195	8
2.3.2. Rregullore (AKA) Nr. 01/2024 për punën e Komisionit të Ankesave	9
2.3.3. Rregullore (AKA) Nr. 02/2024 - Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës	9
2.3.4. Rregullore (AKA) Nr. 03/2024 - Për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe Kompensimin e Ekspertëve të Jashtëm.....	10
2.3.5. Rregullore (AKA) Nr. 04/2024 - Për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit	10
2.3.6. Rregullore (AKA) Nr. 05/2024 Për Procesin e Vlerësimit të AKA nga Institucionet e Arsimit të Lartë.....	11
2.3.7. Rregullore (AKA) Nr. 06/2024 - Për Tarifat dhe Pagesat në AKA.....	11
2.3.8. Politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së AKA.....	12
3. KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË (KShC).....	12
4. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË IAL-VE PËR VITIN 2024	18
4.1 Akreditimi institucional.....	18
4.2 Akreditimi në nivel të programeve të studimit	19
5. KOMISIONI I ANKESAVE (KA)	22
5.1 Baza ligjore.....	22
5.2 Pjesëmarrje në hartim të legjislacionit dhe konferenca/punëtori:.....	22
5.3 Struktura dhe takimet e KA-së:	22
5.4 Vendimmarrja e KA-së.....	23
6. AKTIVITETET PËR NGRITJEN E CILËSISË	24
6.1. AKA organizon trajnim për të gjitha IAL lidhur me përdorimin e platformës E-akreditimi.....	24
6.2. Punëtori me IAL për ndryshimet në zbatimin e standardeve për nivelin institucional dhe të programeve.....	24
6.3. Trajnimi i ekspertëve ndërkombëtarë nga AKA	25
6.4. Monitorimi dhe procedurat pas akredituese në IAL nga AKA	25
6.5. Forcimi i besueshmërisë përmes transparencës së AKA.....	26

6.6. Publikimi i analizës tematike për akreditimin e programeve	26
7. AKTIVITETET DHE NGJARJET KRYESORE TË AGJENCISË SË AKREDITIMIT NË VITIN 2024	27
7.1. Konferenca e dytë ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.....	27
7.2. Vlerësimi nga Asociacioni Evropian ENQA	27
7.3. Partneritetet dhe memorandumet e bashkëpunimit	28
7.4. Pjesëmarrja në Asamblenë e ENQA në Malta.....	28
7.5. Memorandum bashkëpunimi me MAB Hungari.....	29
7.6. Bashkëpunimi me Finlandën në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë ..	29
7.7. AKA merr pjesë në aktivitetet ndërkombëtare të ENQA.....	30
7.9. Transformimi Digjital i AKA-së prezantohet si shembull i suksesshëm në revistën e CEENQA.....	30
8. BASHKËPUNIMI DHE PERKRAHJA NGA INSTITUCIONE DHE PARTNERË 31	
8.1. Përkrahje e AKA nga Projekti 2024 HEI'25.....	31

SHKURTESAT

ADA – Agjencia Austriake për Zhvillim

AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim

CEENQA - Rrjeti i Evropës Qendrore dhe Lindore për Sigurimin e Cilësisë

ENQA - Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë

EQAR - Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë

ESG - Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë

HERAS - Higher Education, Research and Applied Science Plus

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë

IAL publik - Institucionet e Arsimit të Lartë të financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

IAL privat - Institucionet e Arsimit të Lartë të vet-financuara

INQAAHE - Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

KA - Komisioni i Ankesave i cili shqyrton ankesat e pranuar nga IAL për vendimet e KShC-së

KKK – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

KShC - Këshilli Shtetëror i Cilësisë

Ligji për AL - Ligji për Arsimin e Lartë

MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës , Teknologjisë dhe Inovacionit

RVV – Raporti i Vetëvlerësimit

SC - Sigurimi i Cilësisë

UA - Udhëzim Administrativ

WUS Kosova - World University Service Kosova

KSAC – Kodi i fushave të Studimit për Kosove (Kosovo Subject Area Code)

1. HYRJE

Ky dokument është përpiluar me qëllim të raportimit vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2024.

Brenda këtij Raporti janë të vendosura informatat mbi aktivitetet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Komisionit të Ankesave për periudhën njëvjeçare.

Raporti pasqyron:

1. Proceset e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programet tyre të studimit të nivelit të V-të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Bachelor, Master dhe Doktoratës, për vitin 2024;
2. Aktivitetet dhe zhvillimet që kontribuojnë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së punës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si institucion vendimmarrës i AKA-së;
3. Adresimin e rekomandimeve për kthimin e anëtarësisë së plotë në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR); dhe
4. Bashkëpunimin me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) u themelua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në vitin 2008, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. Që nga viti 2023 Agjencia e Kosovës për Akreditim funksionon me Ligjin Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe ka status të agjencisë rregullatore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

AKA bën akreditimin, ri-akreditimin, validimin dhe monitorimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë dhe programeve të tyre të studimit. Përmes procesit të akreditimit, AKA mbështet zhvillimin dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsimin e lartë dhe në këtë mënyrë siguron se ofertat për arsim të lartë në Kosovë përkojnë me standardet e krahasueshme ndërkombëtare.

Baza ligjore për aktivitetin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) janë Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë¹ (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011) dhe Ligji Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim², si dhe aktet nënligjore dhe rregulloret e miratuara nga AKA. Që nga themelimi i saj, AKA në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ESG)³ ka zhvilluar të gjitha standardet dhe procedurat për akreditim dhe i ka publikuar ato përmes ueb faqes së saj zyrtare.⁴

Akreditimi përfshin këto aspekte kryesore:

- Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë;
- Akreditimi i programeve të studimit;
- Akreditimi i degëve të institucioneve dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në ato degë;
- Njohjen/validimin e akreditimit ndërkombëtar;
- Procedurat post-akredituese.

Me qëllim të zhvillimit të një procesi transparent të akreditimit, AKA ofron dokumentet e nevojshme mbi procedurat e akreditimit të cilat mund të shfrytëzohen nga IAL-të, si në vijim: Rregulloret e Standardet e AKA-së, Udhëzuesit e AKA-së për Hartimin e Raportit të Vet-vlerësimit (RVV) për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, përkatësisht Rregulloren e Manualit të Akreditimit⁵. Këto dokumente kanë shërbyer jo vetëm si udhëzues për institucionet e arsimit të lartë për qëllim të procesit të akreditimit, por edhe si udhëzues për sigurimin dhe menaxhimin e brendshëm të cilësisë.

AKA përbëhet nga struktura administrative e saj, e cila udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm, nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i cili është organ qeverisës dhe vendimmarrës i AKA-së, si dhe nga Komisioni i Ankesave.

AKA ka trefishuar numrin e stafit administrativ dhe ka zgjeruar hapësirat e saj të punës për të garantuar që proceset e akreditimit dhe monitorimit të zhvillohen në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

¹ [Ligji nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në republikën e kosovës \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net/Ligji_nr_04_L-037_për_arsimin_e_lartë_në_republikën_e_kosovës)

² [Ligji nr. 08/L-110 për agjencinë e kosovës për akreditim \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net/Ligji_nr_08_L-110_për_agjencinë_e_kosovës_për_akreditim)

⁴ https://www.enqa.eu/ep-content/uploads/2015/11/esg_2015.pdf

⁴ <https://akreditimi.rks-gov.net/guidelines/>

⁵ <https://akreditimi.rks-gov.net/accreditation/standards/>

2.1. Misioni dhe qëllimet e AKA-së

Misioni AKA është të mbështesë zhvillimin dhe ngritjen të vazhdueshme të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë përmes procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të sigurojë shoqërinë e Kosovës se cilësia e arsimit të lartë është në nivelin e standardeve më të larta ndërkombëtare.

Qëllimet e AKA-së janë si në vijim:

- të promovojë, përmirësojë dhe rrisë cilësinë e arsimit të lartë;
- të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në sistemin e arsimit të lartë;
- të përmirësojë cilësinë e studimeve në institucionet e arsimit të lartë;
- të inkurajojë përmbajtje inovative në arsimin e lartë;
- të sigurojë krahasueshmërinë e kualifikimeve nga institucionet e arsimit të lartë të Kosovës me ato të dhëna nga programet ndërkombëtare;
- të zbatojë objektivat për integrimin e Kosovës në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe të kontribuojë në zhvillimin e saj.

Vlerat kryesore në të cilat mbështetet puna e AKA-së janë:

Pavarësia – Vendimet e AKA-së merren në mënyrë të pavarur dhe të arsyetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të verifikueshme;

Transparenca – AKA udhëhiqet nga parimet e përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike përmes një politike efektive të informimit;

Besueshmëria – AKA organizon procese kredibile të sigurimit të jashtëm të cilësisë, ku komuniteti akademik dhe shoqëria në përgjithësi beson në punën e AKA-së;

Profesionalizmi – AKA aplikon standarde të larta profesionale të aplikuara në Evropë në proceset e sigurimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë.

2.2. Anëtarësimet dhe partneritetet

AKA ishte pjesë e rrjeteve ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe vazhdon të jetë edhe për vitin 2024.

Në këtë vit, AKA vazhdon të jetë anëtare e:

- Rrjetit të Agjencive për sigurimin e Cilësisë në Evropën Qendrore dhe Lindore-CEENQA⁶.
- INQAAHE⁷, Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- ENQA Affiliate. AKA ka arritur që të marrë statusin ENQA Aftiliate, pas plotësimit të një varg kriteresh të cilat janë verifikuar nga Bordi i ENQA dhe më pas janë aprovuar nga Asambleja e ENQA në Stokholm.⁸
- AKA është bërë anëtare me të drejta të plota në Global Academic Integrity Network (GAIN). Rrjeti Global i Integritetit Akademik është një konsorcium agjencish për cilësinë dhe integritetin e arsimit në mbarë botën që bashkojnë forcat për të luftuar rritjen e shërbimeve tregtare të mashtrimit akademik që synojnë studentët, dhe ai mbështetet nga një sërë organesh të rëndësishme ndërkombëtare arsimore, si ENQA, Rrjeti Evropian për Integritetin Akademik dhe ETINED.⁹

2.3. Reformat kryesore – miratimi i akteve nënligjore

Si rezultat i aprovimit të Ligjit për AKA në vitin 2023, gjatë vitit 2024 janë aprovuar një varg aktesh nënligjore.

Funksionimi dhe performanca e AKA ndikohen drejtpërdrejt nga kuadri ligjor, përfshirë Ligjin për AKA-në, udhëzimet administrative dhe rregulloret specifike që rregullojnë proceset e vlerësimit, akreditimit dhe menaxhimit të brendshëm të AKA.

2.3.1. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-2195

Bazuar në Ligjin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, respektivisht Neni 28 të këtij ligji që flet për “Kriteret, standardet dhe procedurat e akreditimit”, dhe pikës 10, të këtij neni që flet për “Për bartësit e programit sipas paragrafi 9 të këtij neni, për programet studimore nga radhët e komuniteteve jo shumicë”, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 01b-03/20¹⁰ për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve studimore si dhe programeve nga radhët e komuniteteve joshumicë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë.

⁶ Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education. <https://www.ceenqa.org/>

⁷ The International Network for Quality Assurance Agencies in Higher Education (INQAAHE) <https://www.inqaahe.org/>

⁸ ENQA Affiliate <https://www.enqa.eu/membership-database/kaa-kosovo-accreditation-agency/>

⁹ Global Academic Integrity Network (GAIN) <https://globalacademicintegrity.net/ork/>

¹⁰ Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 01b-03/2024

Bazuar në legjislacionin e lartpërmendur, programet e komuniteteve, do të përfitojnë lehtësira në akreditimin dhe zhvillimin e programeve të komuniteteve në gjuhët e tyre, duke filluar nga viti akademik 2024-2025.

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të vlerësojë përputhshmërinë e bartësve të programeve studimore, për të cilat IAL-të aplikojnë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit, duke përfshirë programet studimore nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga AKA për të gjitha programet e komuniteteve joshumicë që aplikojnë për akreditim dhe riakreditim.

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i vlerave të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Ligjin për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, të cilat përkrahin komunitetet joshumicë në fushën e arsimit.

2.3.2. Rregullore (AKA) Nr. 01/2024 për punën e Komisionit të Ankesave

Rregullorja për Punën e Komisionit të Ankesave¹¹ të AKA përcakton strukturën, funksionet dhe procedurat e këtij organi. Komisioni i Ankesave trajton ankesat e institucioneve të arsimit të lartë ndaj vendimeve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent në vlerësimin e këtyre ankesave.

Procedurat e punës së Komisionit përfshijnë afatet kohore për parashtrimin dhe shqyrtimin e ankesave, mënyrën e mbledhjes së provave dhe marrjen e vendimeve. Gjithashtu, rregullorja përcakton se vendimet e Komisionit janë përfundimtare brenda AKA-së, duke garantuar efikasitet në trajtimin e çështjeve të ngritura nga institucionet e arsimit të lartë.

2.3.3. Rregullore (AKA) Nr. 02/2024 - Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës¹²

Bazuar në këtë rregullore dhe organogramin e ri, AKA ka një strukturë profesionale organizative, në harmoni të plotë me Standardet dhe Udhëzuesit Evropianë (ESG), në harmoni me Ligjin e ri të AKA-së si dhe me legjislacionin e Kosovës në përgjithësi.

Struktura e re e AKA-së përbëhet nga dy departamente, gjashtë divizione dhe njësitë e tjera

¹¹ <https://akreditimi.rks-gov.net/ep-content/uploads/Rregullore-per-Punen-e-Komisionit-te-Ankesave-te-AKA.pdf>

¹² <https://akreditimi.rks-gov.net/ep-content/uploads/Rregullorja-e-AKA-per-Organizimin-e-Brendshem-2024.pdf>

mbështetëse. Stafi i aprovuar i AKA-së do të jetë 32.

Kjo Rregullore krijon një strukturë të qartë organizative, duke përmirësuar efikasitetin operacional të AKA, duke siguruar një përshkrim të qarta të detyrave dhe përgjegjësi, në mënyrë që të rritet profesionalizmi.

2.3.4. Rregullore (AKA) Nr. 03/2024 - Për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe Kompensimin e Ekspertëve të Jashtëm¹³

Rregullorja për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe Kompensimin e Ekspertëve të Jashtëm në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) përcakton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e ekspertëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë. Ajo siguron që ekspertët e jashtëm të jenë profesionistë me përvojë relevante akademike dhe në fushën e cilësisë, duke garantuar një proces vlerësimi të paanshëm dhe të besueshëm.

Procesi i përzgjedhjes realizohet përmes një thirrjeje publike, përmes kriterëve të caktuara për kualifikimin akademik dhe përvojën profesionale. Përzgjedhja e ekspertëve bëhet nga KShC, duke u bazuar në transparencë dhe meritokraci. Ekspertët e përzgjedhur angazhohen për periudha të caktuara dhe duhet të respektojnë standardet etike dhe profesionale gjatë vlerësimit të institucioneve dhe programeve akademike.

Kompensimi i ekspertëve të jashtëm është i përcaktuar në rregullore, duke marrë parasysh kompleksitetin e vlerësimeve dhe kohën e angazhimit të tyre. Pagesat bëhen në përputhje me dispozitat financiare të AKA-së, duke siguruar shpërblim të drejtë për kontributin e ekspertëve në procesin e akreditimit. Gjithashtu, rregullorja parashikon detajet për mbulimin e shpenzimeve dhe parimet mbi konfliktin e interesit për të ruajtur integritetin e procesit të vlerësimit.

2.3.5. Rregullore (AKA) Nr. 04/2024 - Për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit¹⁴

Rregullorja është një dokument kyç që përcakton standardet dhe procedurat për akreditimin,

¹³ <https://akreditimi.rks-gov.net/ep-content/uploads/REGULATION-KAA-No.012025-ON-PROCEDURES-AND-CRITERIA-FOR-EXTERNAL-EVALUATION-BY-INTERNATIONAL-ACCREDITATION-AGENCIES.pdf>

¹⁴ https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/Manuali-i-Akreditimit-Riakreditimit-Validimit-Shqip-2024-1.pdf?utm_source=chatgpt.com

riakreditimin dhe validimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre në Kosovë. Kjo rregullore është hartuar në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG), duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucioneve arsimore në vend.

Rregullorja shërben si udhërrëfyes për AKA, institucionet e arsimit të lartë, ekspertët ndërkombëtarë dhe publikun e përgjithshëm në zbatimin e procedurave të drejta dhe transparente të akreditimit. Ajo përcakton përgjegjësitë kryesore të institucioneve arsimore për sigurimin e cilësisë së shërbimeve që ofrojnë, duke marrë parasysh diversitetin e sistemeve arsimore, institucioneve, programeve dhe studentëve. Gjithashtu, rregullorja inkurajon zhvillimin e kulturës së cilësisë dhe merr parasysh nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, akterëve të tjerë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Rregullorja përmban kritere të qarta për vlerësimin e institucioneve dhe programeve studimore.

2.3.6. Rregullore (AKA) Nr. 05/2024 Për Procesin e Vlerësimit të AKA nga Institucionet e Arsimit të Lartë¹⁵

Kjo Rregullore njihet ndryshe edhe si Rregullorja për Validim. Rregullore përcakton procedurat dhe kriteret e validimit në rastet kur një institucion i arsimit të lartë aplikon për vlerësim të jashtëm në nivel institucional apo për programe studimi nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit.

Gjithashtu, Rregullorja për Validim mbulon rastet kur një institucion i arsimit të lartë, i akredituar nga AKA, në partneritet me një universitet ndërkombëtar, vendos të ofrojë në Kosovë programe studimi të cilat, në vendin e origjinës, janë të akredituara nga agjenci ndërkombëtare të akreditimit.

2.3.7. Rregullore (AKA) Nr. 06/2024 - Për Tarifat dhe Pagesat në AKA

Siç parashihet në Ligjin e AKA-së, Rregullorja përcakton shumën e tarifave që institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës do të paguajnë për akreditim, riakreditim, validim, super ekspertizë dhe procedurat pas akreditimit, si dhe shumën e pagesave për ekspertët ndërkombëtarë.

Me këtë dokument rregullohen aspektet financiare të shërbimeve të akreditimit, duke siguruar stabilitet financiar për AKA dhe transparencë në tarifat e aplikuara.

¹⁵ <https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/Rregullore-per-Procedurat-dhe-Kriteret-per-Vleresimin-e-Jashtem-nga-Agjencia-Nderkombetare-e-Akreditimit.pdf>

2.3.8. Politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së AKA

AKA ka hartuar dokumentin Politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i cili përcakton masat dhe procedurat për të siguruar cilësinë e brendshme brenda agjencisë. Këto politikat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe synojnë të rrisin transparencën, llogaridhënien dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të akreditimit.

Politikat për sigurimin e brendshëm të cilësisë së AKA-së vendosin dhe përshkruajnë në mënyrë formale të gjitha veprimet të cilat realizohen me qëllim të zbatimit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Politikat shërbejnë si mekanizëm kryesor i AKA-së për reflektim të brendshëm dhe janë në përputhje të plotë me angazhimin e AKA-së për vendosjen e një sistemi të funksionimit i cili është i krahasueshëm me agjencitë evropiane të sigurimit të cilësisë.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në AKA sigurohet duke aplikuar ciklin PDCA (planifiko – bëj – kontrollo – vepro). Planifikimi dhe realizimi me kohë dhe në mënyrë të rregullt i proceseve të vlerësimit të jashtëm përpos që parashihet me legjislacionin në fuqi, është indikator esencial i performancës së AKA-së. Në anën tjetër, mbledhja e të dhënave përmes kontrollimit e monitorimit dhe rishikimi i procedurave të brendshme janë parakusht për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Proceset e vlerësimit të brendshëm kontribuojnë edhe në rritjen e transparencës së veprimeve të AKA-së karshi shoqërisë në përgjithësi. Në këtë drejtim, AKA angazhohet në përfshirjen e akterëve relevantë, informacionet kthyese të të cilëve shërbejnë si bazë e rëndësishme për informimin e politikave të AKA-së.

3. KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË (KShC)

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ose Bordi i AKA-së, është organ vendimmarrës i Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë punon duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 dhe Ligjin Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim¹⁶ dhe mbështetet në Rregulloren mbi Punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Nr. 621/18D, dt.12.06.2018).

¹⁶ [Ligji nr. 08/L-110 për agjencinë e Kosovës për akreditim \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)

Legjislacioni në fuqi mundëson përzgjedhjen e anëtarëve të KShC-së mbi bazën e kritereve dhe procedurave profesionale dhe transparente. Lista e përzgjedhur e të nominuarve ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Duke u bazuar në Rregulloren e punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, KShC cakton agjendat vjetore për procesin e akreditimit të IAL-ve, aprovon standardet, procedurat dhe kriteret e akreditimit, aprovon ekipet e ekspertëve të jashtëm të propozuara nga drejtori i AKA, merr vendimet për akreditim si dhe aprovon Statutin dhe rregulloret e AKA.

Përbërja aktuale e KShC-së është si vijon:

1. Prof. Asoc. Dr. Hasnije Ilazi, kryetare;
2. Dr. Klemen Miklavic, nënkryetar;
3. Prof. Ass. Dr. Gëzim Tosuni, anëtar;
4. Prof. Dr. Maja Martinović, anëtare;
5. Prof. Dr. Jaakko Kauko, anëtar;
6. Prof. Dr. Mirlinda Batalli, anëtare;
7. Prof. Dr. Avni Berisha, anëtar;
8. Dr. Jetmir Haxhibeqiri, anëtar,
9. Shkurta Bajgora, studente, anëtare;
10. Drejtori i AKA-së, z. Naim Gashi (sipas detyrës);
11. z. Ermal Sadiku, përfaqësues i industrisë dhe
12. znj. Arieta Pozhegu Vula, përfaqësuese e industrisë.

Prof. Dr. Mirlinda Batalli, Prof. Dr. Avni Berisha dhe Dr. Jetmir Haxhibeqiri janë të zgjedhur nga Parlamenti i Kosovës më dt. 14.02.2024, ndërsa anëtare e re studente Shkurta Bajgora është zgjedhur nga Parlamenti i Kosovës më dt. 05/12/2024.

Tabela 1: Aktivitetet kryesore të KShC për vitin 2024

Nr.	Përshkrimi	Data
1.	Si rezultat i vendimit të KShC-së që thirrja për ekspertë ndërkombëtarë të jetë e hapur gjatë tërë vitit, AKA në vazhdimësi ka pranuar aplikacione të reja për ekspertët ndërkombëtarë dhe KShC ka shqyruar ato gjatë tërë vitit.	2024

2.	KShC ka shqyrtuar dhe ka vendosur për të gjitha raportet e vlerësimit të ekspertëve.	2024
3.	KShC ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e IAL-ve dhe ka shqyrtuar dhe proceduar te Komisioni i Ankesave të gjitha ankesat e IAL-ve.	2024
4.	Me qëllim të rritjes së transparencës dhe përfshirjen e të gjithë akterëve të arsimit të lartë në procesin e vendimmarrjes, KShC ka vazhduar takime me institucionet e arsimit të lartë të akredituara në Kosovë.	2024
5.	KShC është takuar me konferencen e rektorëve për të diskutuar për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.	05.02.2024
6.	KShC ka aprovuar Rregulloren për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe kompensimit e Ekspertëve të Jashtëm.	07.02.2024
7.	KSHC ka mbajtur punëtori për rishikimin e manualit të akreditimit.	25 dhe 26 mars 2024
8.	KSHC ka miratuar Rregulloren për Manualin e Akreditimit	29.04.2024
9.	KSHC dhe AKA kanë pritur një ekip të ekspertëve të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), në kuadër të vlerësimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për zbatimin e standardeve evropiane të cilësisë (ESG 2015).	02-04.07.2024
10	KShC dhe AKA kanë organizuar konferencën ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë	24.09.2024
11	KShC ka miratuar Rregulloren për tarifatat dhe pagesat	08.10.2024
12	KSHC dhe AKA janë takuar me përfaqësuesit e Institucioneve të Arsimit të Lartë të cilat ofrojnë programe në fushën e arteve, me qëllim të diskutimit rreth përcaktimit të kriterëve për bartësit e programeve në këtë fushë.	22.10.2024
13	KSHC dhe AKA kanë pritur në vizitë Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Kosovës	12.11.2024
14	KSHC ka vendosur kriteret për bartësit e programeve të studimit në fushat e arteve	27.11.2024
15	KShC dhe AKA kanë zhvilluar vizita në: Finlandë ku janë zhvilluar takime me Agjencinë homologe të akreditimit FINEEC, Unionin e Studentëve, Universitetin e Helsinkit dhe Universitetin e Tampere-s;	2024

	Forumit e ENQA-s për vitin 2024 në Hanover; Konferencën ndërkombëtare të Këshillit të Turqisë për Cilësinë në Arsim e Lartë (THEQC) ku janë zhvilluar takime me drejtues të agjencive homologe në Evropë; Punimet e Asamblesë së Rrjetit Ndërkombëtar për Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE) dhe në Forumin 2024 në Bukuresht të Rumanisë; Budapest të Hungarisë në Agjencinë homologe të Akreditimit MBA ku edhe u nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet dy agjencive. Asamblenë e Përgjithshme të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në Malta.	
16	KShC raporton në Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport në Parlamentin e Kosovës.	05. 07.2024.

3.1. Mbledhjet dhe vendimet e KShC

Gjatë vitit 2024, KShC ka mbajtur gjithësej 16 mbledhje dhe 1 votime online. Tabela më poshtë liston mbledhjet e mbajtura sipas radhës.

Tabela 2: Lista e mbledhjeve të mbajtura për vitin 2024

Nr	Data	Mbledhjet
1	06-07.02.2024	Takimi i 120 i KShC
2	06.03.2024	Takimi i 121 i KShC
3	22.04.2024	Takimi i 122 i KShC
4	29.04.2024	Takim i jashtëzakonshëm 01/2024

5	20.05.2024	Takimi i 123 i KShC
6	25.06.2024	Takimi i 124 i KShC
7	03.07.2024	Takimi i 125 i KShC (mbledhje e mbajtur në hapësirat e Universitetit të Prishtinës)
8	22.07.2024	Takimi i 126 i KShC
9	12.08.2024	Takimi i 127 i KShC
10	23.08.2024	Takim i jashtëzakonshëm 02/2024
11	09.09.2024	Takim i jashtëzakonshëm 03/2024
12	23.09.2024	Takimi i 128 i KShC
13	08.10.2024	Takimi i 129 i KShC
14	01.11.2024	Takimi i 130 i KShC (mbledhje e mbajtur në hapësirat e Universitetit të Pejës)
15	26.11.2024	Takimi i 131 i KShC
16	09-10.12.2024	Takimi i 132 i KShC

Për secilën mbledhje të KShC-së, vendimet publikohen në ueb faqen zyrtare të AKA-së në profilin zyrtar në Facebook dhe në profilin në LinkedIn.

3.2. Sfidat kryesore të KShC në vitin 2024:

1. **Njohja e diplomave nga rajoni dhe më gjerë mbetet sfidë.** Ekziston një numër i madh i bartësve të programeve që kanë diplomuar si doktor i shkencës në shtet rajonale apo/edhe më gjerë, shtete këto me mungesë të theksuar të kapaciteteve dhe mekanizmeve akreditues sipas ESG standardeve. Njohja e diplomave (nostrifikimi) sipas legjislacionit në fuqi nuk është në harmoni me mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, dhe si rrjedhojë përveç anës formale-procedurale, nuk ofron shqyrtim përmbajtjesor të disertacioneve, duke mundësuar kështu legjitimimin e diplomave me cilësi të dyshimtë. KShC nuk ka mekanizma për mënjanimin nga procesi i akreditimit të bartësve me doktorata të dyshimta apo jo cilësore, gjë që rrezikon sigurimin e cilësisë.

2. **Cilësia e aplikimeve.** Gjatë punës së saj KShC është ballafaquar me cilësinë e dobët të aplikacioneve për akreditim të programeve. Gabime që kanë të bëjë me selektimin e kodeve nga ESAC (ang. Erasmus Subject Area Codes) dhe mospërputhshmëria e tyre me fushën e bartëseve, mospërputhja e kurseve të programit dhe profileve të bartëseve me “learning outcomes” të programit, cilësia e dobët e raporteve të vetëvlerësimit në kuptimin përmbajtësor dhe cilësia e përkthimit në gjuhën angleze, janë disa nga probleme me të cilat ballafaqohet KShC gjatë shqyrtimit të aplikacioneve dhe vendimmarrjes.

Ajo që është evidentuar nga KShC në lidhje me programe të IAL-ve, bazuar në vlerësime të ekspertëve ndërkombëtar gjatë viti 2024, ka qenë performanca më e dobët e IAL-ve në plotësimin e standardit Hulumtimi dhe standardit Misioni, objektivat dhe administrimi. Poashtu, adresimi i rekomandimeve të ekspertëve përmes planeve të aktiviteteve nga IAL, është konstatuar nga KShC si formalitet i plotësuar, dhe jo si angazhim i mirëfilltë i IAL-ve në përmirësimin e gjendjes. Në përgjithësi, mendimi strategjik është një nga dobësitë e mëdha të IAL-ve në përgjithësi.

Në të njëjtën kohë, pas ndryshimeve në platformën E-akreditim, dokumentet e vendosura brenda platformës nga ana e personelit akademik janë treguar me shumë mangësi: duke filluar nga mos vendosja fare të dokumenteve në platformë, e deri të vendosja e dokumenteve të përditësuara, të panënshkruara, me linqe të paklikueshme etj.

Një gjendje e tillë faktike i është prezantuar IAL-ve në takimin vjetor të KShC me IAL-ët.

3. **Aktet nënligjore për Ligjin e AKA.** Ligji për AKA ka hyrë në fuqi në korrik 2023 dhe do të ketë ndikim të madh pozitiv në veprimtarinë e AKA. Sfida mbetet hartimi dhe zbatimi i akteve nënligjore përmes të cilëve do të mundësohet implementimi i plotë i Ligjit në fjalë.
4. **Vizita vlerësuese të ENQA dhe aplikimi për anëtarësimin në EQAR.** Gjatë vitit 2024 është bërë vizita e vlerësimit të plotë të AKA nga ekspertët e ENQA. Sfida kryesore e KShC dhe AKA ka qenë si të arriturat e shumta të prezantohen në mënyrë që ekspertët ndërkombëtarë ta kuptojnë qartë progresin e arritur, por mbi të gjitha kontekstin lokal të implementimit të standardeve. Në këtë drejtim, gjatë periudhës pasuese, anëtarët e KShC dhe AKA kanë ndërmarrë takime të shumta ndërkombëtare konsultative për aplikimin në EQAR pas vlerësimit nga ENQA.

Rikthimi i AKA në ENQA dhe EQAR mbete një nga qëllimeve kryesore strategjike të AKA edhe brenda Strategjisë së re të AKA 2026-2031.

4. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË IAL-VE PËR VITIN 2024

Vlerësimi institucional dhe i programeve të studimit është një aktivitet periodik i AKA-së. Ky proces bazohet në vlerësimin e dokumenteve të dorëzuara nga institucioni aplikues (Raporti i vetëvlerësimit) dhe në bazë të të gjeturave gjatë vizitës në terren me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Bazuar në procedurat e publikuara të AKA-së, çdo IAL duhet të dëshmojë se plotëson kriteret e akreditimit me qëllim të marrjes së akreditimit.

Bazuar në Ligjin për AKA-në, çdo IAL që paraqet kërkesë për akreditim ri/akreditim institucional të një apo më shumë programeve të studimit. Njëkohësisht IAL duhet të paraqesë edhe listën e stafit akademik, të deklaruar në AKA përmes platformës e-akreditimi për angazhim në po atë IAL, në programin përkatës për vitin përkatës akademik. Aplikacioni, së bashku me listën e stafit i nënshtrohet vlerësimit të përmbushjes së kriterëve formale dhe pas aprovimit nga KShC, ai përfshihet në agjendën vjetore të AKA për vlerësim. Në rast të vlerësimit negativ paraprak të aplikacionit nga KShC, ai refuzohet dhe nuk i nënshtrohet vlerësimit. Veç aplikacioneve dhe listat e stafit të aprovuar, IAL duhet të sjellë në AKA edhe Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) i cili i dërgohet ekipit vlerësues të jashtëm në një afat kohor të caktuar para vizitës fizike.

Në vitin 2024 AKA realizoi procesin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit mbi bazën e standardeve të rishikuara në vitin 2021 dhe Rregullores së Manualit të ri të Akreditimit në të cilën duhet të bazohen IAL gjatë hartimit të RVV. Këto standardet synojnë avancimin e cilësisë së përgjithshme të IAL-ve në Kosovë dhe fokusohen në konsolidimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë së tyre.

4.1 Akreditimi institucional


KSHC gjatë vitit 2024 i ka shqyrtuar aplikacionet e institucioneve të arsimit të lartë për akreditim/riakreditim institucional dhe akreditim dhe riakreditim të programeve të studimit.

KShC ka shqyrtuar tetë (8) aplikacione për akreditim/ riakreditim institucional dhe të programeve; nga këto aplikacione 8 janë miratuar për vlerësim nga ekspertët ndërkombëtarë dhe për të gjitha është bërë vlerësimi nga të njëjtët. Nga numri total sa kanë aplikuar (8), shtatë (7) IAL-ët u vlerësuan

pozitivisht dhe një (1) negativisht, të cilit i është refuzuar akreditimi bazuar në vlerësimin e ekspertëve ndërkombëtarë.

4.2 Akreditimi në nivel të programeve të studimit

Për programe të studimit gjatë vitit 2024 kanë qenë gjithsej 212 aplikacione, nga to 117 aplikacione për programe në nivel bachelor, 90 aplikacione për nivelin master, dhe 5 aplikacione për programe PhD, të cilat janë shqyrtuar nga KSHC.




Kjo tabelë paraqet ndarjen e aplikacioneve për programe studimi gjatë vitit 2024:

- **Bachelor:** 117 aplikacione (55.2%)
- **Master:** 90 aplikacione (42.5%)
- **PhD:** 5 aplikacione (2.3%)

Duke u bazuar në kriteret e parapara në Rregulloren e Manualit për Akreditim, Riakreditim dhe Validim të IAL-ve, KShC ka miratuar për procedurën vijuese (vlerësim të ekspertëve) aplikacionet për 176 programe, (95 aplikacione për nivelin bachelor, 77 aplikacione për nivelin master dhe 4

aplikacione për nivelin PhD), kurse 36 aplikacione për programe janë refuzuar nga KSHC për mospërbushje të kriterëve fillestare.



Bazuar në Rregulloren për Akreditim, Riakreditim dhe Validim të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL):

- Aplikacione të miratuara për procedurën vijuese:

- Bachelor: 95
- Master: 77
- PhD: 4


- Aplikacione të refuzuara për procedurën vijuese:

- 36 programe – për mospërbushje të kriterëve.

Pas miratimit të aplikacioneve nga KShC, administrata e AKA-së ka angazhuar ekspertët ndërkombëtarë për vlerësimin e këtyre programeve. Pas rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë KShC ka akredituar gjithësej 158 programe, prej tyre 86 programe bachelor, 68 programe master dhe 4 programe PhD. Duke u bazuar në vlerësimin e ekspertëve ndërkombëtarë KShC ka refuzuar akreditimet për 18 programe.

REZULTATET E VLERESIMIT

■ Bachelor (Aprovuar) ■ Master (Aprovuar) ■ PhD (Aprovuar) ■ Refuzuar



Përmbledhje e Akreditimeve të Programeve – 2024

Bazuar në rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë, gjatë vitit 2024 janë akredituar gjithsej 158 programe studimi:

- 86 programe në nivelin Bachelor
- 68 programe në nivelin Master
- 4 programe në nivelin PhD

Ndërkohë, 18 programe janë refuzuar për akreditim për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të vlerësimit.

Të gjitha raportet e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendimet e KSHC-së janë publikuar në ueb faqen e AKA-së dhe janë transparente për publikun.

Gjatë vitit 2024 KSHC ka aprovuar edhe dy (2) validime bazuar në vlerësime ndërkombëtare për programe të studimit në Kosovë.

5. KOMISIONI I ANKESAVE (KA)

5.1 Baza ligjore

KA ka kryer autorizimet e veta ligjore bazuar në Rregulloren e Komisionit të Ankesave 02/2019, të cilën e ka miratuar KSHC, dhe e cila është zbatuar nga data 31.05.2019 deri më 05.01.2024.

Më datë 29.06.2023, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligji Nr. 08/L-110 Për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, në të cilin ligj specifikohen autorizimet, struktura, mënyra e vendimmarrjes dhe aspekte tjera relevante për KA.

Me qëllim të normimit më të detajuar të veprimtarisë së KA-së, më datë 05.01.2024 është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja për KA.

5.2 Pjesëmarrje në hartim të legjislacionit dhe konferenca/punëtori:

KA ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare: “*Drejt Përsosmërisë: Harmonizimi i politikave të sigurimit të cilësisë me strategjinë institucionale dhe angazhimin e palëve të interesit*”, organizuar në Prishtinë me datë 24 Shtator 2024.

5.3 Struktura dhe takimet e KA-së:

Gjatë periudhës raportuese ka ndryshuar struktura e përbërjes së KA, duke u zgjedhur anëtarët e rinj nga radhët e juristëve, si dhe duke u rizgjedhur dy anëtarët nga radhët e Profesorëve:

- a) Lirik Veselaj – anëtar jurist – sipas Vendimit: **529/24 i datës: 19.03.2024;**
- b) Nexhat Kelmendi – anëtar jurist – sipas Vendimit: **987/24 i datës: 20.05.2024;**
- c) Ibish Mazreku – anëtar profesor universitar – **sipas Vendimit: 2020/24, i datës: 10.10.2024;**
- d) Fatos Rexhepi – anëtar profesor universitar – **sipas Vendimit: 2020/24, i datës: 10.10.2024.**

3.2 Gjatë periudhës raportuese, përkatësisht më datë 10.10.2024, anëtarit Kemajl Zeqiri i është skaduar mandati.

3.2 KA gjatë periudhës raportuese ka mbajtur gjithsej **27 takime** dhe atë në periudhat si në vijim:

Nr.	Muaji	Takime
1	Janar	1
2	Shkurt	4
3	Mars	3
4	Prill	2
5	Maj	4
6	Qershor	2
7	Korrik	3
8	Gusht	2
9	Shtator	1
10	Tetor	2
11	Nëntor	1
12	Dhjetor	2

TOTAL: 27 takime

5.4 Vendimmarrja e KA-së

KA gjatë periudhës raportuese ka nxjerrënjë numër të caktuar të vendimeve dhe atë, me të dhënat si në vijim:

Nr.	Lloji i Vendimmarrjes	Numri i Vendimeve	Parashtruesit e Ankesave	
1	Aprovim të Ankesës si të bazuar	6	- Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë - Universiteti i Pejës - Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë - Kolegji “UBT” - Kolegji “Universum” - Kolegji “Universum” - Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Makinerisë	
2	Aprovim i pjesërishtëm i Ankesës	2	- Universiteti i Gjakovës - Universiteti i Prizrenit	
3	Refuzim	21	Institucioni	Hera
			Kolegji “Universum”	2
			Kolegji “AAB”	2
			Universiteti i Gjakovës	3
			Kolegji “Biznesi”	1
			Kolegji “UBT”	2
			Kolegji “Dardania”	3
			Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	1
			Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Ndërtimtarisë	2
			Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore	1
			Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Filozofik	1
			Universiteti i Mitrovicës Arsimit Fillor	1
			Universiteti i Gjilanit Arsimit Fillor Juridik Penal	2
TOTAL: 30 Vendime				

6. AKTIVITETET PËR NGRITJEN E CILËSISË

6.1. AKA organizon trajnim për të gjitha IAL lidhur me përdorimin e platformës E-akreditimi

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), ka mbajtur një trajnim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë lidhur me procesin e deklarimit të stafit akademik në platformën e re E-Akreditimi. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë koordinatorët e cilësisë dhe administratorët e sistemeve elektronike në institucionet e arsimit të lartë. Sipas Ligjit të ri të AKA-së, deklarimi i stafit akademik në Republikën e Kosovës bëhet nga data 1 deri më 31 korrik. Platforma e re elektronike E-Akreditimi, është zhvilluar me përkrahjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), nëpërmes projektit HEI 25. AKA posedon të gjitha resurset teknike dhe financiare për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e këtij sistemi. Kjo platformë e re, mundëson digjitalizimin e administrimit të proceseve të akreditimit në Kosovë. Për sigurinë kibernetike të platformës kujdeset Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), në të cilën janë vendosur serverët e platformës.

6.2. Punëtori me IAL për ndryshimet në zbatimin e standardeve për nivelin institucional dhe të programeve

Komfor Ligjit për AKA-në në vitin 2024 hyjnë në fuqi standardet e reja të akreditimit/ riakreditimit, të cilat standarde janë në përputhje me standardet evropiane të cilësisë ESG dhe përfshirjen e shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovë. Për t'u siguruar që IAL i kanë të qarta të gjitha proceduara dhe standardet e vlerësimit të Akreditimit/ riakreditimit të institucioneve dhe programeve të studimit, AKA ka organizuar një trajnim për institucionet e arsimit të lartë (IAL), ku janë prezantuar Rregullorja e Manualit të ri i Akreditimit/Riakreditimit, Rregullorja për Standardet për Akreditim Institucional, Rregullorja për Standardet për Akreditim të programeve të studimit Bachelor dhe Master, si dhe Rregullorja për Tarifa dhe Pagesat në AKA.

Nga përfaqësuesit e AKA-së u prezantuan ndryshimet kryesore në këto rregullore dhe njëkohësisht iu përgjigjën pyetjeve të shumta nga pjesëmarrësit me qellim që të ofrojnë informacione të qarta dhe të sakta, në mënyrë që IAL-të të punojnë në sigurimin e cilësisë në përputhje me standardet.

Ky trajnim kishte për qëllim që të përmirësojë kuptimin dhe zbatimin e standardeve dhe rregulloreve të reja, duke siguruar një proces më të qartë dhe transparent të akreditimit për të gjitha IAL-të.

6.3. Trajnimi i ekspertëve ndërkombëtarë nga AKA

Para fillimit të vlerësimit të institucioneve dhe programeve të studimit AKA ka organizuar një trajnim gjithëpërfshirës për ekspertët ndërkombëtarë të cilët janë angazhuar në procesin e akreditimit institucional dhe të programeve akademike.

Ky trajnim është fokusuar në ndryshimet më të fundit në standardet dhe rregulloret e akreditimit, duke synuar ofrimin e informatave të plota për ekspertët mbi kriteret dhe pritshmëritë e reja. Pjesëmarrësit janë udhëzuar në mënyrë të detajuar mbi hartimin e raporteve të vlerësimit dhe metodologjinë e vlerësimit të përputhshmërisë me standardet e cilësisë.

6.4. Monitorimi dhe procedurat pas akredituese ne IAL nga AKA

Monitorimi dhe procedurat pas akredituese të IAL-ve nga AKA është një proces kryesor për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Ky proces mbështetet në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe rregulloret e AKA-së, të cilat përcaktojnë kornizën ligjore dhe metodologjinë e vlerësimit të vazhdueshëm të institucioneve dhe programeve të tyre akademike.

Monitorimi ka për qëllim të sigurojë që institucionet të përmbushin standardet e përcaktuara dhe të garantojnë një arsim cilësor për studentët. Në përmbledhje, monitorimi i IAL-ve nga AKA është një mekanizëm thelbësor për të siguruar përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë, duke kontribuar në zhvillimin e një arsimi të lartë të qëndrueshëm dhe konkurrues. Gjatë vitit 2024 AKA ka bërë monitorimin në formën online të të gjitha IAL në Kosovë dhe gjithashtu në formën fizike nëntë IAL.

Gjithsejtë janë kryer 5 procedura të monitorimit të cilat janë publikuar në ueb faqen e agjencisë.¹⁷

Procedura pas akredituese e ka për qëllim sigurimin që IAL do të punojnë në mënyrë të vazhdueshme në plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga ekipi eksperteve në raportin final të vlerësimit, gjatë akreditimit të tyre. Me procedurën post-akredituese perfundon cikli i plotë i akreditimit.

Gjatë vitit 2024 janë përfunduar tri procedura të pas akreditimit të cilat janë publikuar në ueb faqen e AKA.¹⁸

¹⁷ <https://akreditimi.rks-gov.net/monitoring/>

¹⁸ <https://akreditimi.rks-gov.net/post-accreditation/>

6.5. Forcimi i besueshmërisë përmes transparencës së AKA

Transparenca është një nga shtyllat kryesore për ndërtimin e besimit dhe legjitimitetit të AKA në raport me institucionet e arsimit të lartë (IAL) dhe palët e tjera të interesit.

Përmes qasjes së hapur dhe komunikimit të vazhdueshëm, AKA synon të sigurojë informim të qartë dhe të plotë mbi vendimet dhe proceset e saj. Në këtë drejtim, publikimi i të gjitha vendimeve të marra nga KShC, si dhe dokumentacioni ligjor dhe procedural në uebfaqen zyrtare të AKA-së, përbën një hap kyç në promovimin e përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë institucionale.

Kjo qasje mundëson që IAL-të dhe të gjitha palët e interesit të kenë qasje të drejtpërdrejtë në informacionet më të fundit mbi standardet, rregulloret dhe procedurat, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e përgjegjësisë në arsimin e lartë.

Po ashtu, më qëllim të rritjes së transparencës, të gjitha mbledhjet e KShC monitorohen nga përfaqësuesit e shoqërisë civile.

6.6. Publikimi i analizës tematike për akreditimin e programeve¹⁹

AKA në bashkëpunim me eksperte amerikane, Christine Austin, ka zhvilluar dokumentin “Analiza tematike e proceseve të përfshira në Akreditimin/Riakreditimin e Programeve të Studimit: Një shqyrtim i tri viteve të proceseve të akreditimit të një programi studimor”, (në të dyja nivelet, baçelor dhe master) në tri institucione publike dhe në tri private në Republikën e Kosovës.

Në qendër të kësaj analizës është reflektuar ndërveprimi në mes standardeve të akreditimit të programeve të studimit që rregullojnë procesin e vlerësimit të programeve.

Në kuadër të këtij aktiviteti, është bërë analiza e raporteve të vetëvlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe atyre raporteve përfundimtare të ekspertëve ndërkombëtarë të angazhuar nga AKA. Në këtë analizë u përfshinë 6 institucione (3 publike/3 private) përgjatë harkut kohor prej 3 vitesh me qëllim të identifikimit të pikave të përbashkëta dhe dallimeve gjatë proceseve të vlerësimit, identifikimin e fushave të përmirësimit, sfidave si dhe identifikimin e trendëve brenda vetë proceseve të vlerësimit.

¹⁹ <https://akreditimi.rks-gov.net/ep-content/uploads/Analiza-tematike-e-procese-te-perfshira-ne-Akred-Riakre-e-Programeve-te-Studimit.pdf>

Kjo iniciativë është zhvilluar brenda konceptit të Programit “Specialist Fulbright”, dhe i sponsorizuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së me financim nga Qeveria Amerikane dhe e zbatuar nga World Learning.

Gjatë këtij procesi AKA ka ndërtuar mekanizma dhe ka ngritur kapacitetet e brendshme për zhvillimin e analizave dhe raporteve tematike për nevoja të ngjashme të AKA për të ardhmen.

7. AKTIVITETET DHE NGJARJET KRYESORE TË AGJENCISË SË AKREDITIMIT NË VITIN 2024

7.1. Konferenca e dytë ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë

AKA ka organizuar më 24.09.2024 Konferencën Ndërkombëtare me titull: “Drejt Përsosmërisë: “Harmonizimi i politikave të sigurimit të cilësisë me strategjinë institucionale dhe angazhimin e palëve të interesit“, në të cilën kanë marrë pjesë mbi 150 pjesëmarrës nga Kosova dhe partnerë ndërkombëtarë duke përfshirë Gjermaninë, Kroacinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Finlandën, Çekinë, Bullgarinë, Slloveninë, Bosnjë e Hercegovinën, Maqedoninë, etj.

Në konferencën ka marrë pjesë dhe ka mbajtur fjalim edhe përfaqësuesja e Regjistrisë Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Në këtë konferencë kanë diskutuar udhëheqës institucionalë, ekspertë, akademikë, hulumtues dhe praktikues të ndryshëm nga fusha e arsimit të lartë, së bashku me studentë dhe punëdhënës, për të eksploruar kolektivisht trendet më të fundit, sfidat dhe praktikat në menaxhimin strategjik të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

Partnerët ndërkombëtarë janë zotuar për përkrahjen e AKA-së dhe i kanë vlerësuar të arriturat për zbatimin e plotë të standardeve evropiane të cilësisë.

7.2. Vlerësimi nga Asociacioni Evropian ENQA

Një ekip i ekspertëve të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), nga data 2 deri më 4 korrik 2024, e kanë vlerësuar Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) për zbatimin e standardeve evropiane të cilësisë (ESG 2015).

Vizita ka përfshirë intervista me menaxhmentin e AKA-së dhe akterët e arsimit të lartë në Kosovë. Vlerësimi do të shërbejë si dokument bazë për aplikim për regjistrim në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR)

7.3. Partneritetet dhe memorandumet e bashkëpunimit

Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit luan një rol kryesor në forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së sistemit të akreditimit. Përmes partneriteteve strategjike dhe shkëmbimit të praktikave të mira, AKA synon të forcojë pozicionin e saj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nga menaxhmenti dhe stafi i AKA-se janë realizuar takime individuale dhe në grupe të vogla me përfaqësues të IAL-ve në Republikën e Kosovës për konsulta dhe informata të rëndësishme rreth proceseve dhe shërbimeve që ofron AKA, për të diskutuar për rezultatet, sfidat dhe detyrat e përbashkëta në ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Përveç takimeve vendore, përfaqësuesit e AKA kanë marr pjesë edhe në takime ndërkombëtare, dhe më raste kanë nënshkruar edhe memorandume të bashkëpunimit.

7.4. Pjesëmarrja në Asamblenë e ENQA në Malta

Në Asamblenë e ENQA të mbajtur në Malta në nëntor 2024 është diskutuar për rishikimin e standardeve dhe udhëzuesve evropian për sigurimin e cilësisë (ESG 2015). Standardet e reja evropiane do të hyjnë në fuqi në vitin 2027, ndërsa vendet anëtare kanë një periudhë kalimtare për adaptimin e tyre.

Në vigjilje të Asamblesë së ENQA, delegacioni i AKA-së është takuar me Presidentin e ENQA, me drejtorin e ri të Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), si dhe me përfaqësues të agjencive homologe nga rajoni dhe Evropa. Në të gjitha takimet, partnerët evropianë kanë theksuar se AKA ka bërë reforma të thella dhe ka shënuar progres evident në funksion të zbatimit të standardeve evropiane, që kanë ndikuar në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Gjatë takimeve është vlerësuar lartë edhe organizimi i Konferencës ndërkombëtare të AKA-së, e cila u mbajt muajin e kaluar në Prishtinë.

7.5. Memorandum bashkëpunimi me MAB Hungari

Gjatë takimit me agjencinë homologe në Hungari, AKA ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi në fushën e cilësisë së arsimit të lartë me Komitetin për Akreditim të Hungarisë (MAB).

Të dy agjencitë janë pajtuar të shkëmbejnë informacione dhe ofrojnë këshilla profesionale të ndërsjellta për aktivitetet dhe proceset, për ofruesit e arsimit të lartë që veprojnë në secilin shtet, si dhe për zhvillimet në sistemet e arsimit të lartë të secilit vend.

AKA dhe MAB janë pajtuar që të përfshijnë vlerësues ose specialistë nga sistemet e njëra-tjetres për të forcuar dimensionet ndërkombëtare të proceseve të vlerësimit të secilës palë.

Gjithashtu janë pajtuar që të bashkëpunojnë në projekte dhe aktivitete të dakorduara reciprokisht, për përfitimin e të dyja palëve, përfshirë vlerësimet e jashtme kundrejt standardeve specifike profesionale, zhvillimin e procedurave, rregulloreve, trajnimeve, seminareve, punëtorive, mbështetjen e mobilitetit të stafit, dhe kryerjen e kërkimeve në çështje që lidhen me sigurimin e cilësisë.

7.6. Bashkëpunimi me Finlandën në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë

Finlanda ka tradita dekadash në avancimin e cilësisë në universitetet e kërkimeve dhe universitetet e shkencave të aplikuar përmes auditimit dhe një gamë të ndryshme të qasjeve të vlerësimit. FINEEC, agjencia finlandeze për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë, ishte nikoqire kryesore e vizitës studimore të AKA në Finlande. Delegacioni i AKA në mars 2024, vizitoi institucionet dhe palët e përfshira në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Helsinki dhe Tampere të Finlandës.

Një nga potencialet e identifikuar të bashkëpunimit është inkurajimi i ekspertëve finlandezë për të aplikuar për tu bërë pjesë në ekipet e vlerësimit të jashtëm të AKA-së, sikur dhe bashkëpunimi i AKA me përfaqësuesit e organizatave studentore të Finlandës. Prandaj, gjatë vizitës delegacioni i AKA është takuar edhe me unionet studentore finlandeze që marrin pjesë aktivisht në proceset e sigurimit të cilësisë, kryesisht duke deleguar përfaqësuesit e tyre në grupet e punës dhe organet vendimmarrëse në nivel universitetesh dhe në nivel kombëtar. Perspektiva e studentëve për cilësinë është një element i rëndësishëm i kulturës së cilësisë finlandeze.

7.7. AKA merr pjesë në aktivitetet ndërkombëtare të ENQA

Gjatë muajit dhjetor 2024 stafi i AKA-së ka marrë pjesë në dy ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare të organizuara nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në Bruksel, Belgjikë.

Gjatë këtyre aktiviteteve, ekipi i AKA-së kanë bashkëbiseduar edhe Presidentin e ENQA, drejtoreshën e ENQA, si dhe drejtues të lartë të agjencive homologe në Evropë, mbi bashkëpunimin në ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Mbështetur nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, këto aktivitete kanë ofruar mundësi për përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe për fuqizimin e bashkëpunimin ndërkombëtar.

7.8. Bashkëpunimi me AZVO-Kroaci

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në arsimin e lartë, AKA ka përfituar nga përvoja dhe praktikat më të mira ndërkombëtare përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Kroacisë për Shkencë dhe Arsimin e Lartë (AZVO). Ky bashkëpunim ishte pjesë e projektit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), i cili synon të mbështesë vendet e Ballkanit Perëndimor në forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Në takim në rolin e nikoqirit AKA ka pritur delegacionin nga AZVO, ku gjatë takimit, palët diskutuan për përfitimet e AKA-së nga ky projekt dhe për mundësitë e shkëmbimit të përvojave për përmirësimin e proceseve të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë.

7.9. Transformimi Digjital i AKA-së prezantohet si shembull i suksesshëm në revistën e CEENQA²⁰

AKA është prezantuar në Revistën e Rrjetit të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEENQA) për vitin 2024, ku një artikull i veçantë thekson transformimin digjital të procesit të akreditimit dhe përkushtimin për cilësi në arsimin e lartë.

Artikulli përshkruan kalimin inovativ të AKA-së drejt një platforme të digjitalizuar për proceset e akreditimit, duke rritur efikasitetin dhe transparencën në arsimin e lartë. Ky hap përfaqëson një transformim të rëndësishëm që fuqizon sistemin e akreditimit dhe përafrohet me praktikat më të mira ndërkombëtare.

²⁰ <https://www.ceenqa.org/wp-content/uploads/CEENQA-Neësletter-2024.pdf>

Ky publikim është një dëshmi e rëndësisë së rritjes së shtrirjes ndërkombëtare të AKA-së dhe angazhimit të saj për të ndarë përvojat dhe praktikat e mira me komunitetin më të gjerë të sigurimit të cilësisë.

8. BASHKËPUNIMI DHE PERKRAHJA NGA INSTITUCIONE DHE PARTNERË

8.1. Përkrahje e AKA nga Projekti 2024 HEI'25

Në vitin 2024 AKA ka përfituar mbështetje të rëndësishme nga ADA Austria përmes projektit HEI'25, i cili synon fuqizimin e institucioneve të arsimit të lartë përmes ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të mekanizmave të sigurimit të cilësisë. Ky bashkëpunim ka ndikuar pozitivisht në avancimin e proceseve të akreditimit, monitorimit dhe digjitalizimit të operacioneve të AKA-së, duke e përafruar më tej sistemin e arsimit të lartë në Kosovë me standardet ndërkombëtare.

Përkrahje nga projekti 2024 HEI'25, ka përfshirë asistencën teknike, trajnimin e stafit dhe ekspertëve, zhvillimin e politikave të reja dhe integrimin e praktikave të avancuara në sistemin e akreditimit. Përmes kësaj përkrahjeje, AKA synon të rrisë efektivitetin dhe transparencën e saj, duke forcuar rolin e saj si garantuese e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Njëkohësisht, ADA ka përkrahur financiarisht edhe digjitalizimin e shërbimeve të AKA.

Procesi i deklarimit të stafit akademik dhe aplikimi për procesin e akreditimit/riakreditimit të programeve të studimit, është avancuar dhe modernizuar gjatë vitit 2024 nëpërmes zhvillimit të platformës së re E-akreditimi. Përmes platformës E-akreditimi është bërë deklarimi i stafit akademik brenda afatit ligjor 1 deri më 31 korrik kur janë deklaruar 3005 mësimdhënës të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Digjitalizimi i shërbimeve të brendshme të AKA-së ka përfshirë procedurat e aplikimit për akreditim, proceset monitoruese, deklarimin e stafit akademik, informimin akademik, gjenerimin e konfirmimeve etj.

Softueri për akreditim ka pesë lloje të ndryshme të shfrytëzuesve: zyrtarët e AKA-së, ekspertët ndërkombëtarë, menaxhmentin dhe stafin e IAL-ve, studentët. Platforma ka mundësuar interaksion në mes të akterëve të ndryshëm, sipas detyrës dhe përgjegjësisë së tyre. Njëkohësisht ka mundësuar ngritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e efikasitetit, efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien.